



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE SHKODËR

NOTER ARBEN S. KOPLIKU
ADRESA Bulevardi "Zog I", pallati 1.
TEL: 684031111



KONTRATË DHURIMI PASURI E LUAJTSHME (AKSIONE)

Nr. repertori: 1875

Nr. koleksioni: 854

Shkoder më 07/08/2020

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



A2020040400067317500



A2020040400067317500

KONTRATË dhurimi kuota kapitali.

Sot, më datë 07/08/2020 para meje Noter Arben Salim Kopliku anëtar i Dhomës Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Shkoder, me zyrë në adresën Bulevardi "Zog I" Pallati 1, Shkoder, u paraqitën personalisht:

DHURUES: Arigir Sylaj, atësia Ismet, amësia Dije, shtetas Shqiptar, lindur në Shkoder, Shkoder dhe banues në MALESI E MADHE, me adresë 4302 GRUEMIRË CANAJVE 03660018 7 1, lindur më 10/01/1999, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 032980569 dhe nr. personal J901100860, .

(Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si "**Dhuruesi**")

PRANUES I DHURIMIT:

Ardit Reçaj, atësia Qamil, amësia Sema, shtetas Shqiptar, lindur në Gruemire, Shkoder dhe banues në MALESI E MADHE, me adresë 4302 Gruemirë Gruemire 020, lindur më 10/05/1988, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 031869164 dhe nr. personal I80510137D, .

(Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si "**Përfituesi i dhurimit**")

Me kerkesen e paleve te sipershenuara, ne pajtim me kerkesen dhe deklarimet e vullnetshme te bera ne pranine time, une noteri i autorizuar gojarisht nga palet per perdorim dhe trajtim te te dhenave personale te tyre, hartoj dhe vertetoj kete kontrate si me poshte...

-Fakte egzistuese-Deklarime paraprake

-Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë "ARIS TABACCO" shpk nëpërmjet vendimit, date 7 Gusht 2020, ka vendosur nder të tjera dhe miratimin e kërkeses se ortakut Arigir Sylaj, për transferimin nepermjet kontrates se dhurimit te kuotave te kapitalit te shoqerise te zoteruara prej 50 % , nr. i pjeseve 1, në favor të pranuesit Ardit Reçaj, i cili se bashku me pjesen e tij prej 50 %, nr. pjeseve 1, behet pronar i plote i krejt 100 % te kuotave te kapitalit themeltar te Shoqerise "ARIS TABACCO" shpk., dhe nje pjese e tere.

Ortaku Arigir Sylaj është ortakë me 50 % të kuotave nga 100% të kapitalit të shoqërisë "ARIS TABACCO" shpk, shoqeri tregtare e së drejtes shqiptare, e

Ardit Reçaj
hij



regjistruar pranë QKB me nr identifikimi tregtar (NUIS) L88527701F, dhe se deklarohet se ia dhuron tërësisht të gjitha kuotat që zoteron në këtë shoqëri Ardit Reçaj.

Me këtë dhurim të pjesëve të tija takluese (50 %) në këtë Shoqëri, dhuruesi heq dorë dhe nga funksioni i administratorit të kësaj Shoqërie, gje të cilën e mer persiper pranuesi i dhurimit, Ardit Reçaj.

Ardit Reçaj deklaron shprehimisht se pranon dhurimin e 50 % të kuotave të kapitalit themeltar që dhuruesi transferon në pronësi të tij.

Neni. 1 **-Objekti i kontratës**

-Nëpërmjet kësaj kontrate dhurimi, dhuruesi transferon pa shpërblim në favor të pranuesit të dhurimit, Ardit Reçaj, pjesën e tij takluese në këtë Shoqëri prej 50 % të kuotave të kapitalit themeltar, dhe pranuesi i dhurimit, me mirënjohje e pranon dhurimin e bere, e me gjithë pjesën/t e tij takluese prej me 50 % të kuotave të këtij kapitali themeltar, behet pronar i plote dhe i pakundershtueshem i/me të gjithë/a kuotat e kapitalit themeltar (prej 100 %) që zotëron të Shoqëria "ARIS TABACCO" shpk.

Me këtë dhurim të pjesëve të tija takluese (50 %) në këtë Shoqëri, dhuruesi heq dorë dhe nga funksioni i administratorit të kësaj Shoqërie, gje të cilën e mer persiper pranuesi i dhurimit, Ardit Reçaj për një afat tjetër 5 (pese) vjeçar.

Neni. 2- **Qëllimi i kontratës.**

Qëllimi i kësaj kontrate është transferimi tërësisht i pronësisë të pjesëve të kuotave të kapitalit të shoqërisë (50 % të kuotave të kapitalit themeltar) të zotëruara nga dhuruesi Arigir Sylaj, tek pranuesi i dhurimit Ardit Reçaj.

Neni 3- **Garancitë. Disponimi i kuotave.**

-Dhuruesi i kuotave Arigir Sylaj me gjendje civile BEQAR, garanton se është i vetmi titullar i ligjshëm i kuotave që po transferon me këtë kontratë (50 % të kuotave të kapitalit themeltar), se kuotat janë plotësisht të lira nga çdo barrë, detyrim të drejta reale apo çdo lloj kufizimi tjetër (Bashkengjitet konfirmimi i marre nga RBS (Regjistri Barrëve Siguruese).

Gjithashtu, palet në përgjegjesinë e tyre të plote deklarohen se nuk kanë marre asnjë kredi apo detyrim tjetër ndaj Bankave apo të treta, gje të cilën do e saktësojë dhe RBS që do merret ditën e hënë, se sot si e premtë pasdite RBS nuk punon , e duke shtua se dhuruesi është me punë në Tiranë, dhe e ka të pamundur ardhjen në një ditë tjetër.

Neni 4 **-Përgjegjësitë . Heqja dorë nga të drejtat.**

-Dhuruesi deklaron nën përgjegjësinë e tij personale se me nënshkrimin e kësaj kontrate, ai heq dorë nga të gjitha të drejtat që i kanë takuar në cilësinë e ortakut me 50% të kuotave të Shoqërisë "ARIS TABACCO" shpk apo çdo të drejtë tjetër pa kufizim, ku përfshihen të drejta pune, dividendi etj".

Me këtë dhurim të pjesëve të tija takluese (50 %) në këtë Shoqëri, dhuruesi heq dorë dhe nga funksioni i administratorit të kësaj Shoqërie, gje të cilën e mer persiper pranuesi i dhurimit, Ardit Reçaj për një afat tjetër 5 (pese) vjeçar.

Ardit Reçaj



Neni 5 **-Detyrimet e përfituesit**

-Pranuesi, përfituesi merr përsipër njohjen dhe respektimin e të gjitha detyrimeve financiare e ligjore që gjinden në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate në emër e për llogari të Shoqërisë "ARIS TABACCO" shpk, qofshin këta institucione shtetërore, palë të treta apo kreditore të shoqërisë e sidomos Banka e institucione buxhetore, si dhe çdo detyrim tjetër ligjor që rrjedh nga zotërimi i kuotave të Shoqërisë "ARIS TABACCO" shpk.

-Dhuruesi që kalon kuotën behet përfitues dhe përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga casti i kalimit të kuotave deri në çastin e regjistrimit të kalimit të kuotave prane QKB.

Neni 6 **Mosmarrëveshjet**

-Palët, dhuruesi dhe pranuesi i kuotave angazhohen të bëjnë çdo përpjekje për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve apo konfliktet të mundshme që mund të krijohen midis tyre, lidhur me këtë kontratë nëpërmjet negociemeve të drejtpërdrejta.

Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve apo konflikteve midis tyre, çështja do t'i nënshtrohet juridiksionit gjyqësor pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkoder.

Neni 7. **Efektet e kontratës**

-Kjo kontrate ka fuqinë e ligjit për palët nga moment i nënshkrimit të saj para noterit, dhe mund të ndryshohet vetëm me marrëveshje dypaleshe me shkrim..

-Kontrata ka efekt për palët e treta, mbështetur e sipas dispozitave ligjore në fuqi.

-Kjo kontrate u lidh me titull akt kalimi i kuotave pjesmarrese të kapitalit (50 % të tyre), dhe i njihet e drejta e kryerjes së procedurave ligjore të regjistrimit prane QKB (Qendra Kombëtare e Biznesit).

Kontrates i bashkëngjiten :

QKB e kësaj Shoqërie.

RBS, vertetim i cili do të nxiret të henen.

Certifikate familjare e dhuruesit të kuotave.

Dokumentet e identifikimit të paleve.

Kushte të tjera midis paleve, nuk ka,

-Baza Ligjore

-Si baze ligjore e përpilimit të kontrates dhe zgjidhjes së çdo konflikti të mundshëm, bazuar në Kodin Civil në fuqi të Republikës së Shqipërisë, nenit 73 të ligjit nr 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" si dhe sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit, si dhe ligjet dhe urdhetarv e urdheresat në vijim

-Të gjitha kushtet e tjera që nuk trajtohen në këtë Kontratë janë të zbatueshme për palët sipas akteve ligjore dhe nëligjore në fuqi.

-Dispozita të Ndryshme

-Kontrata kartohet në 4 (kater) kopje origjinale të njëjta, prej të cilave një për

Andi A. Reçej

RJ



arshiven noteriale, dhe kopjet e tjera paleve, per te ndjekur procedurat e depozitimit pranë QKB.

-Paleve, pasi rane dakord per çdo gje, iu lexua kjo kontrate, te cilet u shprehen se e kane kuptuar dhe e pranojne ate sic eshte redaktuar me siper.


Pasi une Noteri ua lexova paleve te pranishme tekstin e plote te kesaj kontrate me kater faqe, te cilen ato e kuptojne; ne pranine time pranojne se eshte hartuar ne perputhje te plote me vullnetin e tyre te lire e te plote, e në zbatim të nenit 102 të ligjit nr 110 datë 20. 12. 2018 «Për Noterinë», e nënshkruajne kontraten rregullisht në praninë time si noter:

DHURUES

Arigis Lylar




PRANUESI I DHURIMIT

Andi Kesaraj


Noter
Arben Salim Koplaku



FATURË

Emri i Përdoruesit:

ARBEN
SALIM
KOPLIKU

Adresa:

BULEVARDI ZOGU I, P. 1
SHKODER-SHKODER
SHQIPERI

Nr. i Llogarise:

400-053

Date:

07.08.2020

Pershkrimi:

D-20200807102544634

Balanca Perpara:

Leke 1,900.00

Debi

Leke 1,900.00

Balanca Aktuale:

Leke 0.00

Komente:

Pagese kerkim regjistrimi



[Handwritten signature]
[Handwritten signature]

REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit të Kërkimit: D-20200807102544634
Data e Rezultatit të Kërkimit: 07.08.2020
Ora e Rezultatit të Kërkimit: 10:25:44AM
Lloji i Kërkimit:
Numri i Dokumentit: D-400-053-3270
Referenca e Perdoruesit:



LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KËRKIMI 0

ARIGIR ISMET SYLAJ
ARIS TABACCO SH.P.K.



Handwritten signature in blue ink.

Large handwritten signature in blue ink.